



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DEÇANI / OPŠTINA DEÇANI

Drejtoria për Inspekcione

10 Nr. _____

Datë: 29.1.2019

Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës



Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione

Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për vitin 2018

Drejtoria për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, gjate vitit kalendarik 2018 kanë kryer kryer punët dhe detyrat e punës konform Ligjeve dhe akteve nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2018.

Në Kuadër të Drejtoratit gjatë vitit 2018 kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori Sanitarë, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Aktvendim si punë sekondare), në tremujorin e parë Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë në vepër) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të

produkteve ushqimore si dhe kushtet higjienike dhe sanitare të objekteve dhe stabilimenteve.

Janë ber kontrole inspektuese lidhur me ndërtimet pa leje si dhe të atyre në kundërshtim me lejet e lëshuara nga Drejtorati për Urbanizëm.

Gjatë tremujorit të parë kur ka qenë i angazhuar Inspektori i Veterinës si kompetencë e deleguar nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit është bërë mbikëqyrja e therjes së kafshëve dhe vulosja e mishit të therur neper thertore.

Gjatë vitit 2018 ka qenë shqetësuese gjendja në Gryken e Deçanit sa i përket degradimit të ambientit me rastin e ndërtimit të hidrocentraleve. Vazhdimisht është përcjell minimumi ekologjik i sasisë së ujit në Lumëbardhin e Deçanit dhe është konstatuar se asnjëherë operatori ekonomik i hidrocentraleve nuk i është përmbajte elaboratit mbi minimumin ekologjik të sasisë së ujit në shtratin e lumit. Për të gjeturat e konstatuara vazhdimisht janë njoftuar inspektorët kompetent të MMPH, por për arsye të pa njohura për ne, rezultatet në përmirësimin e gjendjes kanë munguar. Pothuaj gjate tere sezonit veror dhe vjeshtor Lumëbardhi i Deçanit i ka gjasuar një lumi të vdekur. Për të gjeturat e konstatuara është bere edhe denoncim në gjykatën kompetente por çuditërisht gjykata e ka hedhur poshtë gjëja për jo kompetencë të Inspektorit Komunal. Më në fund qështja e këtij degradimi është duke u hetuar edhe nga njësi i krimeve ekonomike të Policisë së Kosovës.

Është bere evidentimi i deponive ilegale në tere territorin e komunës dhe është hartuar plani për pastrimin e tyre si dhe raporti për pastrimin e tyre në kuadër të projektit “Ta pastrojmë Kosovën”.

Çdo javë në ditën e tregut është bere mbikëqyrja e tregu të gjelbër.

Janë bere kontrole sipas kërkesës së policisë posaçërisht për mallrat e hasura ne transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura ne subjektet tregtare, ku vlen të theksohet se ka ekzistuar një bashkëpunim mjaft i mirë.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe te mbrojtjes në punë.

Nder të tjera gjate punës se tyre inspektorët kan kryer aktivitetet si ne vijim:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbalet e hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendimet	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	120	30	75	15	7
I Ndertimit	24	17	17	4	4
I Mbrojtjes së Ambientit	90	6	30		1
Sanitar	46	18	35	12	1
I bujqësisë	Asistim me inspektoret tjerë pothuajse të gjitha inspektimet si shefi i inspekcionit	6	7		
Gjithsejt	280	77	165	31	13

Halil Tolaj